

**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

---

**RREGULLORE**

**PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE PËR  
DHËNIEN E LIÇENCËS PËR TË USHTRUAR VEPRIMTARI SIGURIMI OSE  
RISIGURIMI NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Miratuar me vendimin e Bordit nr.13, datë 08.02.2007

**Neni 1**  
**Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të pikës 6, të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare ” dhe nenit 20 e vijues të Ligjit nr.9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime”.

**Neni 2**  
**Dispozita të përgjithshme**

Kjo rregullore përcakton:

- a) Afatet dhe procedurat e dhënies së liçencës për të ushtruar veprimtari si shoqëri sigurimi ose risigurimi dhe degët e shoqërisë së sigurimit të huaj.
- b) Procedurat e krijimit të zyrës së përfaqësimit në Republikën e Shqipërisë nga shoqëria e huaj e sigurimit.
- c) Procedurat për liçencimin e zgjerimit të veprimtarisë së sigurimit të shoqërisë së sigurimit.

Për efekt të zbatimit të kësaj Rregulloreje termat e përdorur në të kanë të njëjtën kuptim si ato të shprehur në nenin 3, të Ligjit nr.9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime” i shprehur si “Ligji” në këtë rregullore.

### **Neni 3**

#### **Autoriteti liçencues**

3.1 Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, i cili në këtë rregullore do të quhet Autoriteti, në zbatim të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare ” është i vetmi autoritet që lëshon liçencën si akt administrativ për dhënien e të drejtës së ushtrimit të veprimtarisë së sigurimit.

3.2 Për të ushtruar veprimtari sigurimi, shoqëria e sigurimit dhe dega e shoqërisë së huaj të sigurimit duhet të liçenohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, konform rregullave dhe procedurave të parashikuara në “Ligjin” dhe në këtë Rregullore.

3.3 Bordi i Autoritetit është organi i vetëm, i cili merr vendimin për dhënien, refuzimin dhe tërheqjen e liçencave të parashikuara në këtë Rregullore.

3.4 Departamenti i Liçencimit dhe Monitorimit pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga subjektet e interesuar për t’u liçencuar, si dhe mban korrespondencën me përfaqësues të tyre.

### **Neni 4**

#### **Llojet e liçencave**

4.1 Autoriteti në zbatim të “Ligjit” jep llojet e liçencave të mëposhtme:

- a) “Liçencë për ushtrim veprimtarie.”
- b) “Liçencë për zgjerim veprimtarie.”
- c) “Liçencë për ushtrim veprimtarie të degës së shoqërisë së huaj.”

4.2 Liçenca është e pakufizuar në kohë dhe e patransferueshme.

### **Neni 5**

#### **Fazat e liçencimit**

5.1 Liçencimi i veprimtarisë së sigurimit përfshin dy faza:

- a) Miratimi paraprak.
- b) Liçenca.

5.2 E drejta për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së sigurimit lind vetëm pasi shoqëria dhe dega e shoqërisë së huaj të sigurimit është pajisur me liçencë nga Autoriteti.

### **Neni 6**

#### **Forma ligjore e shoqërisë së sigurimit**

6.1 Shoqëria e sigurimit krijohet ligjërisht si një shoqëri anonime në zbatim të ligjit për shoqëritë tregtare dhe “Ligjit”.

6.2. Shoqëria liçenohet si:

- a) Shoqëri sigurimi.
- b) Shoqeri risigurimi.
- c) Shoqëri sigurimi dhe risigurimi.
- d) Degë e shoqërisë së huaj të sigurimit.

### **Neni 7**

## **Kapitali i kërkuar për fillimin e veprimtarisë**

Kapitali i kërkuar për fillimin e veprimtarisë nga shoqëria e sigurimit ose risigurimit është ai i parashikuar në nenin 17 dhe 98 të "Ligjit".

### **Neni 8**

#### **Depozitimi i kapitalit themeltar**

Kapitali themeltar depozitohet në një llogari bankare qëllimore me të njëjtin emër, në njërën nga bankat në territorin e Republikës së Shqipërisë, atje ku shoqëria ka selinë qendrore të saj.

### **Neni 9**

#### **Forma e paraqitjes së kërkesës për miratimin paraprak**

9.1 Kërkesa për ushtrim veprimtarie si shoqëri sigurimi, paraqitet me shkrim pranë Autoritetit sipas formularit nr.1 bashkëlidhur kësaj Rregulloreje dhe shoqërohet me dokumentacionin e parashikuar në nenin 26, të "Ligjit". Dokumentacioni duhet të jetë i plotësuar në gjuhën shqipe në tekstin origjinal ose fotokopjen e noterizuar të tij.

9.2 Autoriteti ka të drejtë të kërkojë informacione të tjera shtesë, përveç sa parashikohet më sipër, mosdhënia e të cilave përbën shkak për refuzimin e miratimit paraprak të licencës.

### **Neni 10**

#### **Programi i veprimtarisë**

10.1 Programi i veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit ose risigurimit të propozuar përmban kërkesat e parashikuara në nenin 24, të "Ligjit".

Përveç sa parashikuar më lartë shoqëria duhet të paraqesë edhe informacionin si më poshtë:

a) Vlerësimi i sistemit të sigurimeve, konkurrentet, karakteristikat e tregut të sigurimeve dhe tendencat e zhvillimit të tij.

b) Strategjia e shoqërisë së sigurimit të propozuar, objektivat, pozicioni i saj në treg.

9.2 Në veçanti, për shoqëritë e sigurimit të jetës, llogaritja për parashikimin eprimeve përfshin në mënyrë të qartë dhe të hollësishme si më poshtë:

a) Tabelën e mortalitetit.

b) Metodën për llogaritjen e primit si dhe tabelat e primeve për;

i) sigurimin individual,

ii) sigurimin në grup.

c) Metodën për llogaritjen e rezervës.

d) Metodën e llogaritjes së vlerës së përfituar nga anulimi i kontratës së sigurimit.

e) Llogaritjen e të ardhurave nga investimet, llogaritjen e surplusit, si dhe madhësia dhe mënyra e shpërndarjes.

f) Deklarimin e llojeve të bonuseve që shoqëria do të aplikojë, burimet e planifikuara për mbulimin e tyre si dhe mënyrën e llogaritjes dhe të shpërndarjes së tyre.

## **Neni 11**

### **Plani i biznesit**

Plani i biznesit për tre vitet e para, hartohet sipas kërkesave të parashikuara në nenin 24 të “Ligjit”.

## **Neni 12**

### **Dokumentacioni i kërkuar për burimin e kapitalit**

12.1 Për burimin e kapitalit paraqitet dokumentacioni si më poshtë:

- a) Kur si burim janë të ardhurat e individit, ato vërtetohen nëpërmjet paraqitjes së dokumenteve të tilla si vërtetimin e pagës nga punëdhënësi, librezë kursimi, çertifikatë depozitë, akt trashëgimie, aktin e dhurimit, etj. të shoqëruara me dokumentacionin që vërteton pagimin e detyrimeve fiskale (tatim-taksave) mbi këto të ardhura.
  - b) Kur si burim janë të ardhurat nga veprimtaria e personit fizik tregtar ose personit juridik, ato vërtetohen me paraqitjen e bilanceve kontabël të audituar, të shoqëruara me dokumentacionin që vërteton pagimin e detyrimeve fiskale (tatim-taksave) mbi këto të ardhura.
  - c) Deklaratën noteriale të aksionerëve direkt, se burimi për kapitalin fillestar të shoqërisë që nuk është hua, kredi ose paradhënie nga subjekte të treta ose veprimtari të paligjshme.
- 12.2 Autoriteti ka të drejtë të kërkojë sqarime dhe të bëjë verifikime të mëtejshme për të dalë qartë burimi i krijimit të parave që do të shërbejnë si kapital i shoqërisë së sigurimit.

## **Neni 13**

### **Dokumentacioni i kërkuar për aksionerët**

13.1 Për aksionerët direkt (themeluesit) e shoqërisë së sigurimit:

- a) Akt-marrëveshja e krijimit të kësaj shoqërie dhe objekti i veprimtarisë së saj.
- b) Lista e themeluesve të shoqërisë së sigurimit, numri i aksioneve të propozuara për çdo aksioner direkt.
- c) Struktura e aksionerëve të shoqërisë së sigurimit, duke përfshirë aksionerët direkt dhe indirekt të saj.
- d) Lista e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit të propozuar.

13.2 Kur aksionerët direkt janë persona juridikë:

- a) Vendimi i regjistrimit në gjykatë, akti i themelimit dhe statuti i personit juridik, duke përfshirë të dhënat për adresën e saktë të selisë, përshkrimin e veprimtarisë, shumën e kapitalit, listën e aksionerëve/ortakëve dhe pjesëmarrjen e tyre në kapital, si dhe pjesëmarrjet e tyre influencuese në shoqëri të tjera; çertifikatën e regjistrimit në organin tatimor.
- b) Të dhënat për veprimtarinë tregtare për 3 vitet e fundit të çdo personi, që propozon të zotërojë, vetë ose së bashku me personat juridikë të lidhur, pjesëmarrje influencuese në shoqërinë e sigurimit të propozuar, shumën e propozuar për zotërim si dhe pasqyrat financiare, pasqyrat e të ardhurave dhe të shpenzimeve të shoqërisë dhe pasqyrën e rrjedhjes së parasë për aktivitetet e biznesit të tyre në 3 vitet e fundit. Dokumentet e

mësipërme të jenë të shoqëruara me kopjen e raportit të ekspertit kontabël që ka bërë kontrollin e shoqërisë.

- c) Të dhëna për reputacionin e personit juridik aksioner i shoqërisë së propozuar.
- d) Vërtetim nga autoritetet përkatëse për shlyerjen e detyrimeve të tatim- taksave nga aksionerët direkt për 3 vitet e fundit të aktivitetit të tyre.
- e) Deklaratë për shlyerje të detyrimeve dhe për shlyerje të rregullta të kredive (nëqoftëse ka).

13.3 Kur aksionerët direkt janë persona fizikë tregtarë ose individë:

- a) Për personat fizikë tregtarë: të dhëna për bizneset ku ata kanë pjesëmarrje influencuese dhe për çdo pjesëmarrje përqindja e aksioneve/kuotave që disponojnë, akti i regjistrimit të shoqërisë, çertifikata e regjistrimit në organin tatimor, të dhëna që nuk është subjekt i procedurave të likuidimit dhe falimentimit nëpërmjet deklaratës personale.
- b) Për individët të dhëna personale: emër, mbiemër, adresa, kombësia, shtetësia, edukimi, punësimi aktual dhe për 3 vitet e fundit dhe interesat pasurore apo të biznesit, dëshmi penaliteti.
- c) Të dhëna për pjesëmarrjen e tyre në këshillat drejtues, në këshillat mbikëqyrës dhe në organet drejtuese të shoqërive të tjera ose të organizatave të biznesit.
- d) Të dhëna për lidhjet që mendohet të ketë midis aktivitetit të tyre dhe shoqërisë së sigurimit të propozuar.
- dh) Të dhëna mbi llogaritë bankare të tyre.
- e) Të dhëna për veprimtaritë tregtare ose profesionale për 3 vitet e fundit të çdo personi fizik tregtar ose individ, që propozon të zotërojë pjesëmarrjen influencuese të shoqërisë së sigurimit të propozuar, si dhe për secilën shoqëri ku ai ka pjesëmarrje influencuese paraqiten pasqyrat financiare, pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe pasqyrën e rrjedhjes së parasë së tyre për 3 vitet e fundit.
- f) Të dhëna për reputacionin e personit fizik tregtar ose të individit.
- g) Vërtetim nga autoritetet përkatëse për shlyerjen e detyrimeve të tatim-taksave nga personi fizik tregtar ose individ për 3 vitet e fundit.
- h) Deklaratë personale të personit fizik tregtar ose e individit, lidhur me shlyerjen e detyrimeve dhe shlyerje të rregullta të kredive( nëqoftëse ka).

## **Neni 14**

### **Dokumentacioni i kërkuar për drejtuesit**

14.1 Për drejtuesit e shoqërisë së sigurimit të propozuar, në Autoritet paraqitet lista e tyre duke përcaktuar:

- a) Anëtarët e këshillit mbikëqyrës.
- b) Anëtarët e drejtorisë.
- c) Anëtarët e Komitetit të Kontrollit të Brendshëm.
- d) Financieri.
- e) Juristi.
- f) Aktuari.
- g) Personi i ngarkuar me marrjen në sigurim.
- h) Trajtuesi i dëmeve.
- i) Mjeku për shoqëritë që kërkojnë të liçenohen për sigurimin e jetës.

14.2 Për secilin prej personave të përcaktuar në pikën 14.1 të këtij neni, të paraqitet dokumentacioni i mëposhtëm:

- a) CV personale.
- b) Fotokopje të pasaportës.
- c) Dëshminë e penalitetit.
- d) Dëshmi aftësie dhe liçenca të ndryshme profesionale.
- e) Lista e bizneseve ku ata kanë pjesëmarrje duke përfshirë si ato biznese ku zotërojnë aksione/kuota, ashtu edhe ato me të cilët kanë lidhje të tjera, e shoqëruar me informacionin përkatës me të dhënat për veprimtarinë e tyre tregtare ose profesionale për 3 vitet e fundit.
- f) Lista e bizneseve ku ata kryejnë funksione drejtuese.
- g) Raportet financiare aktuale të bizneseve ku kanë pjesëmarrje influencuese apo në të cilat ata kanë funksione drejtuese.
- h) Kopje të vendimit të asamblesë së përgjithshme të aksionerëve ose të Këshillit Mbikëqyrës për zgjedhjen/emërimin e tyre.

14.3 Për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, anëtarët e Drejtorisë, anëtarët e Komitetit të Kontrollit të Brendshëm përveç sa më lartë të kenë plotësuar kërkesat e Rregullores së Autoritetit “Për organet drejtuese të shoqërive të sigurimit.”

14.4 Për mjekun e shoqërisë së sigurimit të jetës përveç sa më lartë do të paraqitet edhe dokumentacioni si më poshtë:

- a) Vërtetimin e kryerjes së studimeve të larta në mjekësi.
- b) Eksperiencë pune në profesion jo më pak se 5 vjet.
- c) Eksperiencë profesionale në fushën e sigurimeve jo më pak se 3 vjet.

## **Neni 15**

### **Afatet për verifikimin e dokumentacionit**

15.1 Autoriteti bën verifikimin e plotësimit të dokumenteve të paraqitura në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

15.2 Autoriteti brenda 6 muajve nga data e pranimit të kërkesës për liçencë, jep ose refuzon miratimin paraprak dhe njofton me shkrim shoqërinë për vendimin e tij.

15.3 Data e pranimit të kërkesës për liçencë, konsiderohet data kur kërkuesi ka plotësuar të gjitha kërkesat, sipas “Ligjit” dhe kësaj rregulloreje. Kjo datë i njoftohet me shkrim nga Autoriteti kërkuarit dhe që nga ky moment fillon llogaritja e afatit 6 mujor parashikuar në pikën 15.2 të këtij neni.

15.4 Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë, nuk përmbush kërkesat e “Ligjit” si dhe kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, Autoriteti do të dërgojë një njoftim për mangësitë, për konfliktet me ligjin si dhe do të kërkojë informacion shtesë.

15.5 Mangësitë dhe vërejtjet e tjera të konstatuara në dokumentacionin e paraqitur sipas kësaj rregulloreje, të mënjanohen brenda një muaji nga data e njoftimit të tyre. Në rast të kundërt, dokumentet e paraqitura i kthehen personit që ka paraqitur kërkesën.

## **Neni 16**

### **Procedurat e shqyrtimit të dokumentacionit**

16.1 Departamenti i Liçencimit dhe Monitorimit, Sektori i Liçencimit, përgatit informacionin dhe jep opinionet për Bordin e Autoritetit lidhur me kërkesën e paraqitur pasi:

- a) Ka analizuar të gjithë informacionin e siguruar nëpërmjet materialit të paraqitur, duke bërë verifikimet e duhura.
- b) Ka organizuar takime me drejtuesit e propozuar të shoqërisë për të diskutuar objektivat e saj në treg, planbизнесin e paraqitur, organizimin e shoqërisë, projektet financiare të shoqërisë për tre vitet e ardhshme, politikat kryesore të propozuara, etj.
- c) Ka vlerësuar të gjithë dokumentacionin e paraqitur duke konsideruar edhe takimin e organizuar dhe sigurohet që plotësohet kualifikimi i nevojshëm i drejtuesve të shoqërisë.
- d) Ka vlerësuar transparencën e strukturës së kapitalit aksioner të shoqërisë.
- e) Ka vlerësuar në bazë të planbизнесit të paraqitur të renë që do të sjellë kjo shoqëri në treg, si dhe parashikimin e mbijetesës së saj në kushtet e ekzistencës së konkurrencës së lirë në treg.
- f) Ka shqyrtuar burimin e krijimit të kapitalit dhe strukturën e tij duke njoftuar Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.
- g) Ka vlerësuar strukturën organizative të shoqërisë së propozuar.
- h) Ka vlerësuar planbизнесin e paraqitur, nëse ai është real dhe bindës.
- j) Ka vlerësuar rrezikun që parashikon të ndërmarrë shoqëria për periudhën trevjeçare, sipas planbизнесit të paraqitur, për të krijuar bindjen nëse shoqëria do të zhvillojë një aktivitet të sigurtë dhe të suksesshëm.
- l) Ka vlerësuar cilësinë e anëtarëve të Drejtorisë dhe të stafit ekzekutiv të propozuar.
- m) Ka vlerësuar mundësinë e aksionerëve të propozuar të shoqërisë për të shtuar kapitalin, nëqoftëse do të jetë i nevojshëm për të mbuluar humbjet që mund të rezultojnë nga ushtrimi i veprimtarisë së sigurimit.

16.2 Autoriteti kërkon ndryshimin e emërimit të shoqërisë së propozuar, kur ky krijon një konfuzion në publik, ose midis shoqërive të sigurimit ekzistuese.

16.3 Departamenti i Liçencimit dhe Monitorimit, Sektori i Liçencimit në informacionin dhe në opinionet për Bordin e Autoritetit në lidhje me kërkesën e një shoqërie të huaj sigurimi për të hapur degë në Republikën e Shqipërisë, përveç kërkesave të pikës 16.1 të këtij neni, përfshin edhe të dhënat e mëposhtme për vendin e origjinës:

- a) Kushtet ekonomike dhe politike.
- b) Sistemin financiar dhe pozicionin në treg të kësaj shoqërie.
- c) Skemën e mbikëqyrjes për aktivitetin e sigurimit dhe aftësinë e autoritetit të mbikëqyrjes së sigurimeve për ushtrimin e këtij funksioni.
- d) Praktikën e kontabilitetit që zbatohen.

16.4 Departamenti i Liçencimit dhe Monitorimit, Sektori i Liçencimit në verifikimin e dokumentacionit të paraqitur për përgatitjen e materialit sipas pikës 15.1 të këtij neni, bashkëpunon me punonjësit e Autoritetit, organe të tjera shtetërore, si dhe me organe homologe për rastet e shqyrtimit të kërkesës së shoqërisë së huaj të sigurimit.

## **Neni 17**

### **Miratimi paraprak ose refuzimi**

17.1 Bordi i Autoritetit jep miratimin paraprak, në rast se shoqëria ka plotësuar kërkesat sipas nenit 26, të “Ligjit” dhe akteve nënligjore.

17.2 Bordi i Autoritetit refuzon miratimin paraprak, në rast se shoqëria nuk ka përmbushur kushtet e kërkuara nga “Ligji” dhe aktet nënligjore në fuqi dhe njofton me shkrim kërkuuesin për vendimin e saj.

17.3 Bordi i Autoritetit shpjegon arsyet në bazë të të cilave informacioni i paraqitur nga shoqëria, vlerësohet i pamjaftueshëm për të vendosur dhënien e miratimit paraprak.

### **Neni 18**

#### **Njoftimi i vendimit**

18.1 Vendimi i Bordi i Autoritetit për miratimin ose refuzimin paraprak duhet të jetë i arsyetuar dhe i bëhet e ditur shoqërisë me shkrim brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit përkatës.

18.2 Në vendimin e miratimit paraprak për liçencë, Bordi i Autoritetit mund të përcaktojë kërkesa dhe kushte të arsyetuara shtesë, që duhet të plotësojë shoqëria për të marrë liçencën për fillimin e veprimtarisë së saj.

### **Neni 19**

#### **Regjistrimi në gjykatë**

19.1 Pas marrjes së miratimit paraprak, shoqëria regjistrohet në Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë, si shoqëri sigurimi.

### **Neni 20**

#### **Dhënia e liçencës**

20.1 Shoqëria e sigurimit ose dega e shoqërisë së huaj, të cilës i është dhënë miratimi paraprak, pasi ka plotësuar kërkesat e nenit 29 të “Ligjit”.

20.2 Autoriteti, para dhënies së liçencës, organizon një verifikim në vend të kushteve në të cilat shoqëria e sigurimit do të zhvillojë aktivitetin, për të përcaktuar nëse janë kryer përgatitjet e nevojshme për fillimin e aktivitetit. Verifikimi ka për qëllim të vlerësojë nëse shoqëria ose dega e shoqërisë së huaj disponon materialet e printuara të nevojshme për kryerjen e aktivitetit të sigurimit, si dhe nëse janë krijuar kushtet për shërbimin ndaj klientit, etj.

### **Neni 21**

#### **Afati i shqyrtimit**

21.1 Autoriteti shqyrton brenda dy muajve nga data e depozitimit të dokumentave të plotësuar sipas kërkesave të “Ligjit” dhe kësaj rregulloreje, dhe merr vendim.

21.2 Nëse shoqëria, brenda 6 muajve nga data e marrjes së vendimit për miratimin paraprak të kërkesës për liçencë, nuk plotëson kushtet e përcaktuara në këtë rregullore për marrjen e liçencës, miratimi paraprak i kërkesës për liçencë bëhet i pavlefshëm, me përjashtim të rasteve kur ky afat është shtyrë me vendim të Bordit të Autoritetit. Në rast se shoqëria është pas shtyrjes së afatit nuk i plotëson kërkesat e mësipërme humbet të drejtën për marrjen e liçencës.

21.3 Autoriteti ka të drejtë të shtyjë afatin e shqyrtimit të kërkesës për liçencim deri në 3 muaj, për raste objektivist të vërtetueshme, për të cilat Autoritetit i duhet koha e nevojshme për shqyrtim.

## **Neni 22**

### **Miratimi ose refuzimi i liçencës**

Bordi i Autoritetit jep liçencën në rast se shoqëria ka plotësuar kërkesat e “Ligjit” dhe kësaj rregulloreje, ose refuzon atë kur nuk janë përmbushur këto kërkesa.

## **Neni 23**

### **Publikimi i liçencës**

23.1 Liçenca për ushtrim veprimtarie botohet në Fletoren Zyrtare dhe në Buletinin e Autoritetit.

23.2 Vendimi për dhënien e liçencës hyn në fuqi menjëherë pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

23.3 Shoqëria e sigurimit duhet të informojë me shkrim Autoritetin për datën e fillimit të veprimtarisë së saj.

23.4 Shoqëria e sigurimit duhet të fillojë punë brenda 6 muajve nga data e marrjes së liçencës.

## **Neni 24**

### **Informacion për fakte të tjera**

24.1 Faktet e reja dhe rethanat e konstatuara pas dhënies së miartimit paraprak si dhe ndryshimet që ato sjellin në dokumentat e paraqitura të cilat kanë shërbyer si bazë për miratimin paraprak, do t’i njoftohen me shkrim Autoritetit.

24.2 Njoftimi sipas paragrafit të parë të këtij neni do të bëhet brenda 15 ditëve pas ndodhjes së faktit ose konstatimit të rrethanave përkatëse.

## **Neni 25**

### **Tërheqja e liçencës për ushtrim veprimtarie**

25.1 Liçenca për ushtrimin e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit tërhiqet vetëm me vendim të Bordit të Autoritetit, në rastet e parashikuara në nenin 33, të “Ligjit”.

25.2 Shoqëria së cilës i është tërhequr liçenca, i ndalohet të angazhohet në veprimtari sigurimi e financiare pas hyrjes në fuqi të vendimit të tërheqjes së liçencës dhe detyrohet të likuideojë sa më parë që të jetë e mundur aktivet e saj, të zgjidhë marrëdhëniet kontraktore për policat e jetës dhe të shlyejë detyrimet e saj. Gjatë kësaj kohe shoqëria vazhdon të jetë subjekt i “Ligjit”, njësoj sikur të ishte e liçencuar.

## **Neni 26**

### **Publikimi**

26.1 Vendimi për tërheqjen e liçencës botohet në Fletoren Zyrtare dhe në Buletinin e Autoritetit.

26.2 Autoriteti dërgon vendimin për botim brenda 5 ditëve nga data e marrjes së tij.

### **Neni 27**

#### **Regjistrimi në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare**

27.1 Autoriteti mban një regjistër të veçantë për regjistrimin e të dhënave të shoqërive të liçencuara, sipas kërkesave të nenit 42, të “Ligjit”.

### **Neni 28**

#### **Kërkesa për liçencim për “zgjerim veprimtarie”**

28.1 Shoqëria e sigurimit e cila ka marrë liçencë për “ushtrim veprimtarie” sigurimi, për një ose disa klasa, duhet të marrë një liçencë nga Autoriteti për të ushtruar veprimtari në klasa të tjera sigurimi, përveç atyre për të cilat është liçencuar më parë.

28.2 Kërkesa për liçencim, për zgjerim veprimtarie referuar në pikën 28.1 të këtij neni, do të bëhet me shkrim duke plotësuar kërkesat e nenit 35 të “Ligjit”.

28.3 Bordi i Autoritetit, jep liçencën sipas parashikimeve të nenit 37, të “Ligjit” dhe kësaj rregulloreje.

### **Neni 29**

#### **Afati i shqyrtimit**

29.1 Bordi i Autoritetit brenda tre muajve nga data e depozitimit të kërkesave të plotësura sipas “Ligjit” dhe kësaj rregulloreje, miraton ose refuzon liçencën “Zgjerim veprimtarie sigurimi”.

29.2 Bordi i Autoritetit, ka të drejtë të shtyjë afatin e shqyrtimit të parashikuar në pikën 29.1 të këtij neni deri në 1 muaj, në raste objektive të vërtetueshme, për të cilat, Autoritetit i duhet koha e nevojshme.

### **Neni 30**

#### **Njoftimi i vendimit dhe publikimi**

30.1 Vendimi për miratimin ose refuzimin e liçencës për zgjerim veprimtarie, i cili jepet nga Bordi i Autoritetit duhet të jetë i arsyetuar dhe i bëhet e ditur shoqërisë së sigurimeve ose degës së shoqërisë së huaj me shkrim brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit përkatës.

30.2 Vendimi për dhënien e liçencës për zgjerim veprimtarie hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

### **Neni 31**

#### **Kërkesa për liçencim për ushtrim veprimtarie të degës së shoqërisë së huaj**

31.1 Kërkesa për liçencimin e degës së një shoqërie të huaj, bëhet nga shoqëria e huaj, me shkrim, në gjuhën shqipe dhe paraqitet pranë Autoritetit duke plotësuar kërkesat e nenit 39, 40 dhe 41 të “Ligjit”.

31.2 Dega e shoqërisë së huaj të sigurimit të liçencuar nuk i lejohet ushtrimi i veprimtarisë së sigurimit, që nuk kryhet nga shoqëria e sigurimit -mëmë.

31.3 Shoqëria e huaj e sigurimit, e cila kërkon të hapë një degë në Shqipëri, deklaron se është e gatshme t’i sigurojë Autoritetit:

a) Çdo lloj informacioni lidhur me gjendjen e saj financiare të konsoliduar, për qëllime të mbikëqyrjes financiare të veprimtarisë së sigurimit.

b) Një informacion për zhvillimet ekonomike aktuale dhe perspektive të vendit të origjinës.

c) Informacion, lidhur me klasifikimin e shoqërisë së sigurimit sipas shoqërive ndërkombëtare të pavarura të specializuara për vlerësimin e institucioneve financiare (International RatingAgency.)

d) Informacion lidhur me çdo ndryshim të rëndësishëm në administrimin, strategjinë, strukturën e pronësisë, gjendjen financiare të shoqërisë së sigurimit.

31.4 Përveç sa parashikuar në nenin 40, të “Ligjit”, administratori i degës së huaj duhet të plotësojë edhe kërkesat e Rregullores së Autoritetit “Për organet drejtuese të shoqërive të sigurimit”.

### **Neni 32**

#### **Miratimi ose refuzimi i kërkesës për ushtrim veprimtarie jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë**

32.1 Shoqëria e sigurimit për të ushtruar veprimtari sigurimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duhet të marrë më parë miratimin e Autoritetit.

32.2 Kërkesa e shoqërisë së sigurimit bëhet me shkrim duke u shoqëruar me dokumentacionin e parashikuar në nenin 43, të “Ligjit.”

### **Neni 33**

#### **Miratimi ose refuzimi i kërkesës për hapje zyre përfaqësimi të shoqërisë së huaj të Sigurimit**

33.1 Kërkesa për hapjen e zyrës së përfaqësimit të një shoqërie të huaj, bëhet me shkrim në gjuhën shqipe nga shoqëria e huaj. Kjo kërkesë i paraqitet Autoritetit duke u shoqëruar me dokumentacionin e parashikuar në nenin 44, të “Ligjit.”

33.2 Autoriteti brenda një periudhe një mujore shqyrton dhe merr vendim në lidhje me kërkesën e shoqërisë së huaj për zyrë përfaqësimi në Republikën e Shqipërisë.

33.3 Autoriteti njofton me shkrim shoqërinë e sigurimit të huaj brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit për miratimin ose refuzimin e kërkesës.

33.4 Zyra e përfaqësimit regjistrohet në gjykatë pasi ka marrë miratimin nga Autoriteti dhe njofton Autoritetin për këtë regjistrim.

### **Neni 34**

#### **Dispozita të fundit**

34.1 Formularët bashkëlidhur janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

34.2 Kjo Rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit.

**Elisabeta GJONI**  
**KRYETAR**